14410 - vendimet gjyqësore / Janë realizuar shpenzime në vlerë prej 127,323.32 € për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore që rrjedhin nga kontratat kolektive në sektorin e arsimit. Këto shpenzime kanë ndikuar në buxhetin komunal, duke zvogëluar mjetet e disponueshme për realizimin e aktiviteteve dhe shërbimeve të planifikuara.

13760 – drutë dhe prodhimet e drurit për ngrohje / Janë realizuar shpenzime në shumë totale prej 119,572.49 €, të shpërndara në programet 93810 - Arsimi Fillor (shuma 92,752.50 €) dhe 95010 - Arsimi i Mesëm (shuma 26,819.99 €). Këto shpenzime lidhen me sigurimin e lëndës djegëse për ngrohje në institucionet arsimore.

13475 – sigurimi fizik i objekteve publike / Janë realizuar shpenzime në shumë totale prej 96,325.50 €, të cilat lidhen me pagesat për sigurimin fizik të objekteve publike. Këto shpenzime janë evidentuar në disa programe buxhetore, përkatësisht në Administratë (objekti i Administratës), Shërbimet e Kujdesit Primar Shëndetësor (QKMF), Shërbimet Kulturore (Shtëpia e Kulturës "Xheladin Kurtaj" dhe Palestra e Sporteve) dhe në Arsimin Fillor dhe Arsimin e Mesëm (shkollat).

Në kategorinë Mallra dhe Shërbime përfshihen kryesisht furnizimet me derivate, materiale për zyrë, pajisje, ushqim dhe pije, shërbimet profesionale dhe kontraktuese, mirëmbajtja e objekteve, automjeteve dhe pajisjeve, shërbimet e teknologjisë informative, internetit dhe telefonisë, shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, përfaqësimit, si dhe shpenzime të tjera për funksionimin e institucioneve komunale.

Shpenzime komunale

Shpenzimet komunale përfshijnë pagesat që lidhen me shërbimet komunale dhe shpenzimet e domosdoshme për funksionimin institucional.

Tabela 8. Përmbledhja e shpenzimeve për Shpenzime komunale - Janar - Shtator 2026

Kodi ekonomik / përshkrimi	16328 Administrata	18028 Shërbime Publike - Infrastruktura Rrugore	18432 Zjarrfikësit Inspektimet	74700 Shërbimet e Kujdesit Primar Shëndetësor	75636 Sherbimet Sociale	85028 Shërbimet Kulturore	92750 Arsimi Parafillor Çerdhet	93810 Arsimi Fillor	95010 Arsimi i Mesem	Gjithsej 2026 (€)	Struktura (%)	Gjithsej 2025 (€)	Dallimi 2026/2025 (€)
13210 - energjia elektrike	20,274.22	78,828.62	578.27	19,186.07	243.03	8,794.14	2,393.98	21,142.89	4,838.70	**156,279.92**	80.09%	102,420.12	53,859.80
13220 - shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit	779.69	56.45	58.94	1,751.81	-	1,640.29	25.05	3,726.81	1,934.66	**9,973.70**	5.11%	9,725.92	247.78
13230 - mbeturinat	5,564.16	-	-	2,056.32	-	1,270.08	3,507.84	7,620.48	4,838.40	**24,857.28**	12.74%	27,609.46	(2,752.18)
13250 - telefonia fikse	1,083.68	-	192.06	797.27	90.84	-	76.93	1,049.44	723.71	**4,013.93**	2.06%	3,531.44	482.49
13260 - pagesat - vendime gjyqësore	-	-	-	-	-	-	-	-	-	**-**	0.00%	13,094.32	(13,094.32)
Gjithsej (€)	**27,701.75**	**78,885.07**	**829.27**	**23,791.47**	**333.87**	**11,704.51**	**6,003.80**	**33,539.62**	**12,335.47**	**195,124.83**	**100.00%**	**156,381.26**	**38,743.57**
Struktura në (%) sipas programeve buxhetore	14.20%	40.43%	0.42%	12.19%	0.17%	6.00%	3.08%	17.19%	6.32%	**100.00%**			

Në kategorinë e shpenzimeve komunale janë realizuar 195,124.83 €, ose 69.74% e buxhetit aktual. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025, shpenzimet janë rritur për 38,743.57 €, përkatësisht 24.78%.

Subvencione dhe transfere

Në kategorinë Subvencione dhe Transfere janë realizuar shpenzime prej 411,064.16 €, ose 62.96% e buxhetit aktual prej 652,851.00 €. Krahasuar me periudhën janar–shtator 2025, shpenzimet janë rritur për 63,928.64 €, ose 18.42%.

Shpërndarja e shpenzimeve sipas programeve buxhetore, kodeve ekonomike dhe detajeve tjera, është paraqitur në tabelat e bashkangjitura (Tabela 9 dhe Tabela 10).

Tabela 9. Përmbledhja e shpenzimeve për Subvencione dhe Transfere - Janar - Shtator 2026

Kodi ekonomik / përshkrimi	16328 Administrata	18028 Shërbime Publike - Infrastruktura Rrugore	18432 Zjarrfikësit Inspektimet	74700 Shërbimet e Kujdesit Primar Shëndetësor	75636 Sherbimet Sociale	85028 Shërbimet Kulturore	92750 Arsimi Parafillor Çerdhet	93810 Arsimi Fillor	95010 Arsimi i Mesem	Gjithsej 2026 (€)	Struktura (%)	Gjithsej 2025 (€)	Dallimi 2026/2025 (€)
21200 - subvencionet për entitetet jopublike	18,500.00	-	-	33,304.18	5,000.00	108,000.00	2,488.99	25,575.00	58,481.00	**251,349.17**	61.15%	256,560.53	(5,211.36)
22202 - transferet për përfitues individual tjerë	68,900.00	-	18,399.99	-	5,000.00	-	19,800.00	840.00	-	**112,939.99**	27.48%	46,499.99	66,440.00
22298 - pagesat për shërbimet e varrimit	-	46,775.00	-	-	-	-	-	-	-	**46,775.00**	11.38%	44,075.00	2,700.00
Gjithsej (€)	**87,400.00**	**46,775.00**	**18,399.99**	**33,304.18**	**10,000.00**	**108,000.00**	**22,288.99**	**26,415.00**	**58,481.00**	**411,064.16**	**100.00%**	**347,135.52**	**63,928.64**
Struktura në (%) sipas programeve buxhetore	21.26%	11.38%	4.48%	8.10%	2.43%	26.27%	5.42%	6.43%	14.23%	**100.00%**			

Gjatë periudhës janar – shtator 2026, janë realizuar shpenzime për mbështetjen financiare të përfituesve individualë, organizatave joqeveritare, bizneseve mikro dhe të vogla, bletarëve, klubeve sportive, shoqatave kulturore dhe artistike, si dhe organizatave që ofrojnë shërbime sociale. Gjithashtu, janë mbështetur nënat lehona, personat në gjendje të rëndë ekonomike dhe shëndetësore, studentët përmes bursave, transporti i nxënësve, përfshirë fëmijët me nevoja të veçanta, si dhe shërbimet e varrimit.

Tabela 10. Detaje - Subvencione dhe Transfere - Periudha 01.01.2026 - 30.09.2026

Kodi/ Programi Buxhetor dhe Emri i Përfituesit	Gjithsej (€)
16028 ZYRA E KRYETARIT	**87,400.00**
QENDRA PER MBROJ. E GRAVE FEMIJVE SHTËPIA IME FERIZAJ	3,000.00
Organizata për Mbrojtjen e Mjedisit GJETHI	5,000.00
Org. e Veteran. të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës - Dega në Kaçanik	4,500.00
Organizata Komunale e Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës-Kaçanik	1,000.00
SHKA GRYKA E KAÇANIKUT	5,000.00
Mbështetja e nënave lehona dhe ndihma momentale për persona me gjendje të rëndë ekonomike dhe gjendje të rëndë shëndetësore	68,900.00
18028 SHËRBIME PUBLIKE - INFRASTRUKTURA RRUGORE	**46,775.00**
Bashkësia Islame e Kosovës - Dega në Kaçanik / shërbimet e varrimit	46,775.00
47028 BUJQËSIA	**18,399.99**
AG-FERM SH.P.K. / Mbështetja e bletarëve me koshere bletësh dhe centrifugë elektrike, për nxjerrjen e mjaltit	18,399.99
48028 PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI EKONOMIK	**33,304.18**
Subvencionimi i bizneseve ekzistuese mikro dhe të vogla (16 përfitues)	33,304.18
75636 SHERBIMET SOCIALE	**10,000.00**
SHPAK HK - HANDIKOS KAÇANIK	4,000.00
Organizata Komunale e Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës-Kaçanik	1,000.00
Ndihma momentale për persona me gjendje të rëndë ekonomike dhe gjendje të rëndë shëndetësore	5,000.00
85028 SHËRBIMET KULTURORE	**108,000.00**
KF LEPENCI KAÇANIK	23,300.00
Shoq. e Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sportit Shkollor KAÇANIK	9,700.00
FONDACIONI BONEVET KAÇANIK	4,750.00
KLUBI I MUNDJES KAÇANIKU	5,120.00
KVK FEMRAT	6,000.00
KLUBI BASKETBOLLISTIK LEPENCI	3,450.00
MOTOKROSS KAÇANIKU	2,600.00
KB KAÇANIKU M	6,080.00
KFFBBK (Bazeli 2015 Femrat)	5,600.00
KLUBI I MOTOÇIKLIZMIT ENDURO KAÇANIKU	3,900.00
KLUBI I VOLEJBOLLIT KAÇANIKU	3,650.00
SHKA TINGUJT E VENDLINDJES	4,500.00
SHOQ.E PESHK.SPOR.REKREA.TROFTA LEPENCIT	1,200.00
NGO CAMP OF MURAL ARTISTS	3,750.00
SHBA KAÇANIKU 2015	2,850.00
QK KAÇANIKU	9,850.00
SHKA GRYKA E KAÇANIKUT	9,900.00
KLUBI I TAEKWONDO KAÇANIKU 2000	1,800.00
92140 ADMINISTRATA	**22,288.99**
Transporti i nxënësve (përfshirë edhe fëmijët me nevoja të veçanta)	7,288.99
Mbështetja e studentëve me bursa (60 përfitues) - pjesa e parë 60 studentë * 5 muaj * 50.00 euro	15,000.00
93810 ARSIMI FILLOR	**26,415.00**
Transporti i nxënësve (përfshirë edhe fëmijët me nevoja të veçanta)	26,415.00
95010 ARSIMI I MESEM	**58,481.00**
Transporti i nxënësve (përfshirë edhe fëmijët me nevoja të veçanta)	58,481.00
Gjithsej (€)	**411,064.16**

Investimet dhe projektet kapitale

Në kategorinë Investime Kapitale / Pasuritë Jofinanciare janë realizuar shpenzime prej 1,831,720.97 €, ose 53.16% e buxhetit aktual të paraqitur në përmbledhje, në shumë prej 3,445,902.57 €. Krahasuar me nëntëmujorin e vitit 2025, shpenzimet janë më të ulëta për 1,102,323.47 €, ose 37.57%.

Sipas pasqyrës së detajuar të investimeve kapitale, nga shpenzimet e kësaj kategorie 593,186.75 € janë evidentuar për vendime gjyqësore. Këto ekzekutime ndikojnë në strukturën e shpenzimeve kapitale dhe duhet të trajtohen veçmas gjatë analizës së realizimit fizik të projekteve.

Sqarim: Diferenca prej 146.85 €, ndërmjet buxhetit aktual të investimeve kapitale në tabelën përmbledhëse dhe atij në tabelën e detajuar, rezulton nga mjetet e participimit të qytetarëve të bartura nga vitet paraprake, përkatësisht 54.85 € për projektin 70942 – Asfaltimi i rrugës L. Lekaj– Doganaj dhe 92.00 € për projektin 86251 – Projekte zhvillimore në bujqësi dhe blegtori.

Tabela 11. Investime kapitale / Pasuritë jofinanciare - Periudha 01.01.2026 - 30.09.2026

Kodi/ Programi Buxhetor dhe Kodi/ Emri i Projektit Kapital	Buxheti 2026 (€)	Buxheti aktual 2026 (€)	Shpenzimet 2026 (€)	Varianca ndaj buxhetit (€)= Buxheti aktual 2026 - Shpenzimet 2026	Ekzekutimi (%)= Shpenzimet 2026/ Buxheti aktual 2026	Shpenzimet për vendime gjyqësore (€)
16328 ADMINISTRATA	**124,000.00**	**124,000.00**	**120,000.00**	**4,000.00**	**96.77%**	**2,193.50**
20869 RREGULLIMI I HAPËSIRËS SË JASHTME TË OBJEKTIT KOMUNAL	2,000.00	2,000.00	0.00	**2,000.00**	**0.00%**	0.00
50993 NDËRTIMI I ANEKSIT TË OBJEKTIT TË ADMINISTRATËS KOMUNALE	2,000.00	2,000.00	0.00	**2,000.00**	**0.00%**	0.00
52636 RREGULLIMI I SISTEMIT TË NGROHJES QENDRORE TË OBJEKTIT TË ADMINISTRATËS KOMUNALE	120,000.00	120,000.00	120,000.00	**0.00**	**100.00%**	2,193.50
17528 BUXHETI	**150,000.00**	**150,000.00**	**111,906.14**	**38,093.86**	**74.60%**	**0.00**
86245 MJETET PËR BASHKËFINANCIM PROJEKTEVE	150,000.00	150,000.00	111,906.14	**38,093.86**	**74.60%**	0.00
18028 SHËRBIME PUBLIKE - INFRASTRUKTURA RRUGORE	**666,311.00**	**681,625.14**	**332,112.30**	**349,512.84**	**48.72%**	**50,000.00**
20868 NDËRTIMI DHE ASFALTIMI I RRUGËS "QEMAJL GURI"	36,000.00	56,000.00	0.00	**56,000.00**	**0.00%**	0.00
51628 NDËRTIMI DHE ASFALTIMI I PJESËS SË MBETUR TË RRUGËS ISMAIL RAKA, SEGMENTI PREJ SHTËPISË SË KULTURËS DERI TE XHAMIA E DËSHMORËVE	2,000.00	2,000.00	0.00	**2,000.00**	**0.00%**	0.00
52699 NDËRTIMI I FABRIKËS PËR TRAJTIMIN E UJIT TË PIJES NË SEPETIN	2,000.00	2,000.00	0.00	**2,000.00**	**0.00%**	0.00
52705 NDËRTIMI I TROTUARIT NË RRUGËN REGJIONALE AHMET KAÇIKU, SEGMENTI RESTAURANT NATYRA - FUSHË E PAJTIMIT	2,311.00	2,311.00	0.00	**2,311.00**	**0.00%**	0.00
52820 NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE	100,000.00	100,000.00	99,999.98	**0.02**	**100.00%**	0.00
52879 NDËRTIMI I KANALIZIMEVE FEKALE DHE ATMOSFERIKE NË LOKALITETET KAÇANIK, DUBRAVË, KAÇANIK I VJETËR, IVAJË, SHTRAZË DHE DOGANAJ	100,000.00	100,000.00	92,419.39	**7,580.61**	**92.42%**	0.00
54389 ASFALTIMI I RRUGËS "HAMËZ JASHARI" SEGMENTI SILKAPOR - RAKAJ	70,000.00	50,000.00	50,000.00	**0.00**	**100.00%**	50,000.00
55191 NDËRTIMI I TROTUARIT DHE NDRIÇIMI PUBLIK NË RRUGËN "FADIL BUNJAKU" BIÇEC	0.00	15,314.14	15,314.14	**0.00**	**100.00%**	0.00
56182 RREGULLIMI DHE ASFALTIMI I RRUGES RUNJEVË-STAGOVË-KAÇANIK I VJETER	150,000.00	150,000.00	24,225.54	**125,774.46**	**16.15%**	0.00
56184 REHABILITIMI DHE ASFALTIMI I RRUGËS BOB - DOGANAJ	2,000.00	2,000.00	0.00	**2,000.00**	**0.00%**	0.00
56185 NDËRTIMI I TROTUARIT, SHTEGUT PËR ÇIKLIZËM DHE REHABILITIMI I RRUGËS "ADEM JASHARI" STAGOVË	150,000.00	150,000.00	0.00	**150,000.00**	**0.00%**	0.00
56339 NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I RRJETEVE TË UJËSJELLËSVE NË KAÇANIK DHE VATAJ TË EPËRME - DUBRAVË	52,000.00	52,000.00	50,153.25	**1,846.75**	**96.45%**	0.00
47028 BUJQËSIA	**80,000.00**	**80,000.00**	**34,020.22**	**45,979.78**	**42.53%**	**0.00**
20872 NDËRTIMI I KANALEVE TË UJITJES NË FSHATRAT VATAJ - REKË - NIKAJ	50,000.00	50,000.00	20,135.50	**29,864.50**	**40.27%**	0.00
20874 NDËRTIMI I RRUGËVE FUSHORE NË BEGRACË	30,000.00	30,000.00	13,884.72	**16,115.28**	**46.28%**	0.00
48028 PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI EKONOMIK	**105,000.00**	**109,395.65**	**55,831.87**	**53,563.78**	**51.04%**	**0.00**
20875 NGRITJA E INFRASTRUKTURËS SË TURIZMIT PËRGJATË LUMIT LEPENCI DHE NË GRYKËN E KAÇANIKUT	80,000.00	80,000.00	29,440.90	**50,559.10**	**36.80%**	0.00
56172 NDËRTIMI I KIOSKAVE PËR BIZNESE NË BULEVARD, NË SHESHIN E QYTETIT DHE NË PIKA TJERA TURISTIKE	25,000.00	25,000.00	21,995.32	**3,004.68**	**87.98%**	0.00
56175 NDERTIMI I BALLKONIT PANORAMIK TE GURI SHPUAR	0.00	4,395.65	4,395.65	**0.00**	**100.00%**	0.00
66445 PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKCIONI	**912,000.00**	**1,074,503.88**	**697,359.05**	**377,144.83**	**64.90%**	**189,922.68**
53279 NDËRTIMI I URAVE MBI LUMIN NERODIME DHE LEPENC	200,000.00	200,000.00	150,000.00	**50,000.00**	**75.00%**	150,000.00
53949 NDERTIMI I NENKALIMIT PER KEMBESORE NEN HEKURUDHEN E QYTETIT	0.00	8,107.25	8,107.25	**0.00**	**100.00%**	0.00
55167 RREGULLIMI DHE ASFALTIMI I RRUGËVE NË PJESËN URBANE	150,000.00	304,396.63	244,778.43	**59,618.20**	**80.41%**	0.00
55169 RREGULLIMI DHE ASFALTIMI I RRUGËVE NË PJESËN RURALE	300,000.00	300,000.00	223,001.62	**76,998.38**	**74.33%**	0.00
56201 NDËRTIMI I KOLEKTORIT PËRGJATË LUMIT LEPENC DHE NERODIME	2,000.00	2,000.00	0.00	**2,000.00**	**0.00%**	0.00
56235 NDËRTIMI I MUREVE MBROJTËSE NË RRUGËN HAMËZ JASHARI - MEJDI DALLOSHI - SHABAN DHE ISEN ELEZI	100,000.00	100,000.00	0.00	**100,000.00**	**0.00%**	0.00
56237 ZGJERIMI I RRUGËS GRYKA E KAÇANIKUT-KAÇANIK I VJETËR	65,000.00	65,000.00	31,549.07	**33,450.93**	**48.54%**	0.00
56350 NDËRTIMI I SHTRETËRVE TË LUMENJËVE DHE PËRROCKAVE	95,000.00	95,000.00	39,922.68	**55,077.32**	**42.02%**	39,922.68
74700 SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR	**150,000.00**	**206,231.05**	**66,604.97**	**139,626.08**	**32.30%**	**46,834.08**
20878 FURNIZIMI ME APARATURA LABORATORIKE BIOKIMIKE PËR QMF DOGANAJ	35,000.00	35,000.00	0.00	**35,000.00**	**0.00%**	0.00
20880 RIKONSTRUIMI I OBORRIT NË QKMF KAÇANIK	60,000.00	60,000.00	46,834.08	**13,165.92**	**78.06%**	46,834.08
54429 NDËRTIMI I DEPOS DHE GARAZHËS NË QKMF	5,000.00	61,231.05	19,770.89	**41,460.16**	**32.29%**	0.00
56258 RENOVIMI I OBJEKTIT TË QKMF-ES	50,000.00	50,000.00	0.00	**50,000.00**	**0.00%**	0.00
75636 SHËRBIMET SOCIALE	**150,000.00**	**150,000.00**	**69,955.00**	**80,045.00**	**46.64%**	**69,955.00**
52979 NDËRTIMI I OBJEKTIT TË QPS-ËS NË KAÇANIK	150,000.00	150,000.00	69,955.00	**80,045.00**	**46.64%**	69,955.00
85028 SHËRBIMET KULTURORE	**300,000.00**	**300,000.00**	**101,286.94**	**198,713.06**	**33.76%**	**46,000.00**
00040 EKZEKUTIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE (NENI 40 LMFPP)		27,376.45	27,376.45	**0.00**	**100.00%**	27,376.45
20882 NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I TERENEVE SPORTIVE NË KOVAQEC DHE STAGOVË	150,000.00	122,623.55	71,342.69	**51,280.86**	**58.18%**	18,623.55
45087 RREGULLIMI I VARREZAVE TË DËSHMORËVE DHE VETERANËVE TË UÇK-SË	150,000.00	150,000.00	2,567.80	**147,432.20**	**1.71%**	0.00
93810 ARSIMI FILLOR	**530,000.00**	**530,000.00**	**213,281.49**	**316,718.51**	**40.24%**	**173,281.49**
00040 EKZEKUTIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE (NENI 40 LMFPP)	113,693.39	113,693.39	113,693.39	**0.00**	**100.00%**	113,693.39
53269 NDËRTIMI I SALLËS SË EDUKATËS FIZIKE NË SHFMU "KADRI ZEKA"	286,306.61	286,306.61	0.00	**286,306.61**	**0.00%**	0.00
56205 VENDOSJA E PANELEVE DIELLORE NË OBJEKTET SHKOLLORE	30,000.00	30,000.00	20,000.00	**10,000.00**	**66.67%**	20,000.00
56220 DIGJITALIZIMI I SHFMU "EMIN DURAKU" KAÇANIK	50,000.00	50,000.00	39,588.10	**10,411.90**	**79.18%**	39,588.10
56223 DIGJITALIZIMI I SHFMU-VE	50,000.00	50,000.00	40,000.00	**10,000.00**	**80.00%**	0.00
95010 ARSIMI I MESËM	**40,000.00**	**40,000.00**	**29,362.99**	**10,637.01**	**73.41%**	**15,000.00**
56225 DIGJITALIZIMI I SHML-VE	20,000.00	20,000.00	14,362.99	**5,637.01**	**71.81%**	0.00
56227 VENDOSJA E PANELEVE DIELLORE NË IAAP - FERIZ GURI DHE VËLLEZËRIT ÇAKA	20,000.00	20,000.00	15,000.00	**5,000.00**	**75.00%**	15,000.00
Gjithsej (€)	**3,207,311.00**	**3,445,755.72**	**1,831,720.97**	**1,614,034.75**	**53.16%**	**593,186.75**

VIII. Buxheti i komunës sipas programeve buxhetore për vitin 2026

Buxheti i miratuar për vitin 2026, sipas planit fillestar, është 13,399,753.00 €, ndërsa buxheti aktual deri në përfundim të periudhës raportuese është 13,836,529.19 €.

Plani i ndarjeve sipas programeve buxhetore, kategorive ekonomike dhe stafit të autorizuar gjendet në 'Tabela 5. Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2026'.

Tabela 5. Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2026

Nr.	Kodi dhe emri i programit buxhetor	Stafi	Paga dhe Shtesa (€)	Mallra dhe Shërbime (€)	Shpenzime komunale (€)	Subvencione dhe Transfere (€)	Investime kapitale (€)	Gjithsej (€)	Struktura (%)
1	16028 Zyra e Kryetarit	27	300,278.00	30,000.00	-	140,000.00	-	**470,278.00**	3.51%
2	16328 Administrata	24	211,725.00	95,000.00	25,000.00	-	124,000.00	**455,725.00**	3.40%
3	16528 Çështje Gjinore	1	12,189.00	5,000.00	-	-	-	**17,189.00**	0.13%
4	16928 Zyra e Kuvendit Komunal	21	220,454.00	15,000.00	-	-	-	**235,454.00**	1.76%
5	17528 Buxheti	11	114,233.00	15,000.00	-		150,000.00	**279,233.00**	2.08%
6	18028 Shërbime Publike - Infrastruktura Rrugore	10	94,444.00	370,000.00	88,000.00	60,000.00	666,311.00	**1,278,755.00**	9.54%
7	18432 Zjarrfikësit Inspektimet	18	175,494.00	10,000.00	2,000.00	-	-	**187,494.00**	1.40%
8	19640 Zyra Lokale e Komuniteteve	1	12,190.00	2,000.00	-	-	-	**14,190.00**	0.11%
9	47028 Bujqësia	4	44,906.00	10,000.00	-	120,000.00	80,000.00	**254,906.00**	1.90%
10	48028 Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik	3	29,942.00	10,000.00	-	50,000.00	105,000.00	**194,942.00**	1.45%
11	66445 Planifikimi Urbanizmi Inspekcioni	13	138,559.00	80,000.00	-	-	912,000.00	**1,130,559.00**	8.44%
12	73037 Administrata (Sh)	3	34,133.00	3,000.00	-	-	-	**37,133.00**	0.28%
13	74700 Shërbimet e Kujdesit Primar Shëndetësor	123	1,230,831.00	305,678.00	30,000.00	-	150,000.00	**1,716,509.00**	12.81%
14	75636 Sherbimet Sociale	8	74,658.00	7,000.00	5,000.00	10,000.00	150,000.00	**246,658.00**	1.84%
15	85028 Shërbimet Kulturore	18	156,482.00	90,000.00	25,000.00	110,000.00	300,000.00	**681,482.00**	5.09%
16	92140 Administrata (A)	7	77,617.00	3,000.00	-	25,000.00	-	**105,617.00**	0.79%
17	92750 Arsimi Parafillor Çerdhet	27	188,175.00	50,000.00	15,000.00	-	-	**253,175.00**	1.89%
18	93810 Arsimi Fillor	404	3,836,686.00	297,000.00	27,000.00	40,000.00	530,000.00	**4,730,686.00**	35.30%
19	95010 Arsimi i Mesem	100	930,309.00	72,302.00	8,000.00	59,157.00	40,000.00	**1,109,768.00**	8.28%
	Gjithsej	**823**	**7,883,305.00**	**1,469,980.00**	**225,000.00**	**614,157.00**	**3,207,311.00**	**13,399,753.00**	**100.00%**
	Struktura në (%) sipas kategorive të shpenzimeve		58.83%	10.97%	1.68%	4.58%	23.94%	**100.00%**	

IX. Vlerësimi i përgjithshëm

Nëntëmujori i vitit 2026 karakterizohet nga një realizim i përgjithshëm buxhetor prej 71.57% dhe rritje e inkasimit të të hyrave vetanake krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025. Granti specifik për arsimin parauniversitar ka shënuar nivel të lartë të shpenzimit, ndërsa investimet kapitale dhe realizimi i planit të të hyrave vetanake kërkojnë angazhim të shtuar gjatë tremujorit të katërt (TM4). Në këtë drejtim, prioritet mbetet intensifikimi i punës në terren, përshpejtimi i realizimit të projekteve kapitale dhe rritja e efikasitetit në inkasimin e të hyrave, me qëllim të përmbushjes së objektivave të planifikuara deri në fund të vitit 2026.

X. Përfundim

Raporti Nëntëmujor Financiar për periudhën 01 janar 2026 – 30 shtator 2026 paraqet gjendjen e realizimit të të hyrave, shpenzimeve dhe investimeve të Komunës së Kaçanikut. Drejtoria për Buxhet dhe Financa do të vazhdojë monitorimin e realizimit të buxhetit, koordinimin me drejtoritë komunale dhe raportimin transparent për përdorimin e mjeteve publike.

REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

Komuna e Kaçanikut

Opština Kačanik/Municipality of Kaçanik

Zyra e Kryetarit

01.Nr.104/102-17511/2026

Kaçanik, 15.10.2026

Në mbështetje të nenit 58, pika h, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 73 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës së Kaçanikut, parashtron këtë:

P R O P O Z I M

Në mbështetje të nenit 12, paragrafëve 12.1 dhe 12.2, nënparagrafit d) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, si Rregullores Nr. 01/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores 01/2018 për bashkëpunimin e Komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane të Komunës së Kaçaniku, Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, në mbledhjen e mbajtur më datë _____, miraton këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR ZGJEDHJEN E KËSHILLAVE LOKALE

Neni 1

Formohet Komisioni për zgjedhjen e këshillave lokale me shtatë (7) anëtarë, me këtë përbërje:

1. _____ – anëtar/e nga Kuvendi i Komunës;
2. _____ –anëtar/e nga Kuvendi i Komunës;
3. _____ – anëtar/e nga Kuvendi i Komunës;
4. _____ – anëtar/e nga Kuvendi i Komunës;
5. _____ – përfaqësues/e nga Ekzekutivi i Komunës;
6. _____ – përfaqësues/e nga shoqëria civile;
7. _____ – përfaqësues/e nga fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane.

Neni 2

Përbërja e Komisionit duhet të sigurojë përfaqësimin gjinor dhe etnik, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 3

3.1 Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me Rregulloren Nr. 01/2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2018 për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane të Komunës së Kaçanikut.

3.2 Komisioni raporton para Kuvendit të Komunës për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

Neni 4

Kryesuesi i Komisionit zgjidhet nga radhët e anëtarëve të Komisionit, në mbledhjen e parë të tij.

Neni 5

Mandati i Komisionit është i lidhur me mandatin e Kuvendit të Komunës.

Neni 6

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Kryetari i Komunës, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme dhe Komisioni për zgjedhjen e këshillave lokale, secili në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësive të veta.

Neni 7

Me këtë vendim njoftohen anëtarët e Komisionit, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Arkivi i Komunës.

Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

A r s y e t i m

Duke pasur parasysh rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Kaçanikut dhe fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, si dhe nevojën për organizimin dhe zhvillimin e procesit të zgjedhjes së këshillave lokale, propozohet formimi i Komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale, me qëllim të sigurimit të një procesi të rregullt, transparent dhe të koordinuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kryetari i Komunës

Z.Sabedin Vishi

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK
REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna Kaçanik
Opstina Kaçanik – Municipality Kaçanik

01.Nr. 60/01-27845/26

Datë 20.10.2026

Duke marrë për bazë faktin që parashtruesi kishte paraqitur kërkesën me nr. 06/360/01-17636/24 të datës 29.07.2024 me të cilën kishte kërkuar lejen për rikonstruktimin tërësor të objektit ekzistues dhe transformimin e tij në një qendër afaristo-banesore moderne. Njoftimin e komunës së Kaçanikut me nr. 06/360/01-17636/24 të datës 31.12.2024 përmes të cilit kishte kërkuar nga këtu parashtruesi që të propozoj një marrëveshje ku përfshihet edhe interesi i komunës, si dhe kërkesën me propozim të parashtruesit të paraqitur pranë organit të komunës me datën 23.06.2026, Drejtori i DUKMM-së, jep këtë:

PROPOZIM

Që Kryetari i komunës të shqyrtoj dhe merr këtë:

VENDIMI

1. **APROVOHET** në parim kërkesa dhe propozim-marrëveshja e parashtruesit për rikonstruktimin tërësor të objektit ish- "Shtëpia e mallrave", dhe transformimin e tij në **Qendër Afaristo-Banesore Moderne**.

Të futet në rend dite për mbledhjen e Kuvendit të Komunës shqyrtimi dhe miratimi i këtij:

VENDIMI

1. **MIRATOHEN** kushtet e përfshirjes së interest publik të Komunës së Kaçanikut në këtë projekt ndërtimor. Sipas propozimit të parashtruesit Ilaz Zharku, i cili përfshin 20% të ndërtimit mbi etazhietet ekzistuese.


2. **AUTORIZOHET** Kryetari i Komunës së Kaçanikut që në emër të Komunës të diskutoj, negocioj dhe të hartojnë **Marrëveshjen** me parashtruesin sipas **Pikës I** të këtij vendimi, ku detajohen të drejtat, obligimet financiare, teknike dhe afatet e realizimit të projektit.

3. Pas dakordimit të Marrëveshjes sipas **Pikës 2**, Marrëveshja do të sjellet në Kuvend për aprovim.

Drejtori i DUKMM-së
z. Korab Krasniqi

Kryetari i komunës
z. Sabedin Vishi

REPUBLIKA E KOSOVËS * KOMUNA E KAÇANIKUT * OPŠTINA KAČANIK * REPUBLIKA KOSOVA


01356-0
01371-0
01370-0
105.67 m²
01373-0
76.09 m²
01372-0
01374-0
01375-0
282.56 m²
115.1 m²
01394-0
01394-0
01381-1
01392-0
150.32 m²

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK

Nr. org.	Data: 23.06.26 Numri	Vendi KAÇANIK Shtojcë
06	350/02 - 15711/26	

PËR: KOMUNËS SË KAÇANIKUT
Kryetarit të Komunës z. ***SABEDIN VISHI***
Drejtorit të DUKMM-së z. ***KORAB KRASNIQI***

NGA: Ilaz Zharku nga Kaçaniku,

- Duke marrë parasysh kërkesën nr. 06-360/01-17636/24 të datës 29.07.2024, Njoftimin me nr. 06-360/01-17636/24 të datës 31.12.2024 dhe Përgjigjen në kërkesë me nr. 2267-2/25 të datës 10.06.2025 parashtruesi paraqet këtë:

KËRKESË

Për ri-konstruimin dhe rritjen etazhitetit të objektit ndërtimor ish "Shtëpia e Mallrave" në Kaçanik

1. HYRJE

- Duke qenë se objekti "Shtëpia e Mallrave" në Kaçanik ishte pronë shoqërore e menaxhuar nga ish ndërmarrja shoqërore "Sharri", ndërsa pas kalimit nën menaxhim të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në vitin 2019 parashtruesi i kësaj kërkese e ka privatizuar objektin e Shtëpisë së Mallrave "Sharri", me synimin që përmes ri-funksionalizimit të saj të kontribuojmë në zhvillimin ekonomik të komunës sonë dhe në gjallërimin e qendrës së qytetit. Megjithatë, për shkak të mungesës së Planit Zhvillimor Komunal, deri më tani nuk kemi pasur mundësi të fillojmë realizimin e projektit.

- Lidhur me këtë, parashtruesi ka paraqitur kërkesën me nr. 06-360/01-17636/24 të datës 29.07.2024 me të cilën kishte kërkuar lejen për rikonstruktim tërësor të objektit ekzistues dhe transformimin e tij në një qendër afaristo-banesore moderne, ndërsa për këtë kishte pranuar nga komuna Njoftimin me nr. 06-360/01-17636/24 të datës 31.12.2024 përmes të cilit ishte kërkuar nga këtu parashtruesi propozimin e një marrëveshje ku përfshihet edhe interesi i komunës, pasi që një pjesë e parcelave ku shtrihet objekti janë në pronësi të komunës.

- Poashtu, duke pas parasysh lejen ndërtimore dhe gjendjen faktike të këtij objekti, shihet që objekti i privatizuar aktualisht shtrihet në prona private të parashtruesit dhe një pjesë e këtij objekti shtrihet edhe në prona publike komunale, dhe atë në pronat: 1319/3, 1371, 1373, 1391, 1392, 1370, 1374, 1375, 1394 dhe 1372, prej të cilave pronat private të tani parashtruesit janë: *1371, 1373, 1370, 1374, 1375, 1394 dhe 1372.*

2. BAZA LIGJORE

-Kjo kërkesë parashtrohet pranë organit kompetent duke u bazuar në:

2.1. Njoftimin e komunës – kërkesës për marrëveshje

-Pas kërkesës së këtu parashtruesit, komuna e Kaçanikut ka lëshuar Njoftimin me nr. 06-360/01-17636/24 të datës 31.12.2024 përmes të cilit ishte kërkuar nga këtu parashtruesi propozimin e një marrëveshje ku përfshihet edhe interesi i komunës, pasi që një pjesë e parcelave ku shtrihet objekti janë në pronësi të komunës.

2.2. Shfrytëzuesi aktual legal dhe faktik i pronës së paluajtshme të komunës

-Parashtruesi i kësaj kërkese është shfrytëzues juridik dhe faktik i pjesëve të pronave të paluajtshme të komunës ku shtrihet objekti ndërtimor "Shtëpia e Mallrave". Kjo sepse, i njëjti me kontratën e lartcekur, ka privatizuar objektin në fjalë, të cilit i është ndarë nga organi kompetent komunal i atëhershëm prona në shfrytëzim dhe i është lëshuar leja ndërtimore për ndërtimin e objektit "Shtëpia e Mallrave", e me të cilën kontratë këtu parashtruesi është bartës i të gjitha të drejtave përkatëse mbi këtë objekt dhe shfrytëzimin e pronës së paluajtshme.

2.3. Objekti ndërtimor është i pajisur me leje ndërtimore

- Parashtruesi i kësaj kërkese, përkatësisht objekti aktual ndërtimor ishte i pajisur me leje ndërtimore, në bazë të së cilës është ndërtuar objekti **B+P+1** *(ndërsa tek pjesa e administratës – zyret është deri në* **+3)** dhe sipërfaqe të përgjithshme **prej 5158,54 m²**.

2.4. Legjislacioni për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës

- Dispozitat e Ligjit nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) – Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, kanë paraparë mundësinë e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës dhe përfitimit të komunës, prandaj parashtruesi i kësaj kërkese:

- propozon organit kompetent që për shqyrtim dhe vendosje të aplikohen procedurat e negocimit nga ana e kryetarit të komunës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 8 dhe nenin 11 të Ligjit nr. 06/L-092.
- vlerëson se në këtë rast **kemi të bëjmë me shfrytëzim aktual të ligjshëm dhe faktik të pronës së paluajtshme të komunës,** ndërsa kjo kërkesë përmbush **poashtu** kriteret të parapara me nenin 5 të Ligjit nr. 06/L-092. Andaj, përmes kësaj kërkese parashtruesi siguron organin kompetent se në të gjitha fazat e ardhshme eventuale do të garantoj **vlerën e investimit** përkatës sipas kërkesave ligjore të parapara në nenin 11 dhe nenit 23 2 të Rregullores (QRK) – Nr.09/2020.

3. QËLLIMI I SHFRYTËZIMIT TË PRONËS

3.1. Shfrytëzimi aktual

-Siç e kemi cekur edhe në fillim të kësaj kërkese, prona lëndore aktualisht është duke u shfrytëzuar nga këtu parashtruesi i kësaj kërkese, e në të cilën është ndërtuar objekti "Shtëpia e Mallrave", **mirëpo e njëjta tash e më shumë se 30 vjet nuk është është funksionale.**

3.2. Shfrytëzimi i ardhshëm:

' "Ndërtimi i objektit afaristo-banesor me ndikim të zhvillimit ekonomik dhe të turizmit"

-Projekti ynë parasheh një rikonstruktim tërësor të objektit ekzistues dhe transformimin e tij në një qendër afaristo-banesore moderne. Gjatë fazës konsultative për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, kemi propozuar ndryshimet përkatëse, të cilat tashmë janë miratuar nga ana Juaj dhe janë përfshirë në planin e propozuar nga komuna.

-Në përputhje me analizat profesionale dhe gjendjen aktuale të objektit, projekti parasheh ndërtimin e një mbindërtimi me destinim banesor në një pjesë të objektit ekzistues, si dhe lidhjen funksionale të tij me hapësirat e zyrave të Shtëpisë së Mallrave. Po ashtu, projekti përfshin rregullimin e hapësirave të parkimit në pjesën e pasme të objektit, të cilat do të jenë në shërbim të klientëve dhe përdoruesve të ndryshëm.

-Njëkohësisht, të gjitha hapësirat ekzistuese të Shtëpisë së Mallrave do të riorganizohen dhe përshtaten sipas standardeve bashkëkohore dhe kërkesave të tregut, me qëllim të tërheqjes së bizneseve dhe brendeve të njohura. Realizimi i këtij projekti do t'i japë një pamje të re jo vetëm kësaj pjese të qytetit, por edhe vetë Kaçanikut.

-Për më tepër, ky projekt do të krijojë vende të reja pune dhe të fuqizojë komunitetin lokal, duke e kthyer qendrën e qytetit të Kaçanikut në një qendër me vlera të ndërthurura historike dhe moderne, tregtare dhe do të ketë ndikim të konsiderueshëm të turizmit lokal dhe rajonal.

4. PROPOZIMI – OFERTA PËR PJESËMARRJE DHE PËRFITIM FALAS TË KOMUNËS

-Duke marrë parasyshë të gjitha të lartcekurat, parashtruesi i kësaj kërkese, komunës së Kaçanikut i:

O F R O N

-10-20% të sipërfaqes së re të ndërtuar në pronësi dhe shfrytëzim komunës së Kaçanikut në emër të shfrytëzimit të pronave të paluajtshme të komunës ku shtrihet objekti. Sipërfaqja e saktë, pozicioni dhe ndarja eventuale fizike e saj, propozojmë që të bëhet me marrëveshje të veçantë në mes të këtu parashtruesit në cilësinë e pronarit/investitorit dhe kryetarit të komunës apo të autorizuarit të tij në cilësinë e përfituesit.

5. KËRKESA

-Duke u bazuar në faktet e lartcekura, përvojën shumëvjeçare të parashtruesit në shfrytëzimin e pronës dhe përmbushjen e obligimeve ndaj Komunës së Kaçanikut, vlerësohet se janë plotësuar kushtet ligjore për miratimin e kësaj kërkese. Njëkohësisht, projekti i propozuar, paraqet një investim të qëndrueshëm që kontribuon në zhvillimin ekonomik lokal, ruajtjen e traditës, vlerave historike dhe krijimin e vendeve të reja të punës, duke qenë në përputhje me interesin publik dhe zhvillimin afatgjatë të Kacanikut.

-Andaj, duke u bazuar në të gjitha sa u parashtruan më sipër, Kryetarit të Komunës së Kaçanikut i propozojmë që:

- **të APROVOJË në parim këtë kërkesë**
- **të adresojë kërkesën për aprovim tek kuvendi i komunës,** pranë të cilit të paraqet këtë kërkesë dhe kërkojë aprovimin e saj, duke përcaktuar me vendim të kuvendit përqindjen e përfitimit të komunës, si dhe të merr autorizimin për nënshkrimin e marrëveshjes së përfitimit dhe ndarjes së saktë të pjesës së sipërfaqes së re të lejuar për ndërtim.

P.S.

DOKUMENTACIONI:

- Parashtruesi i kësaj kërkese, ka përgatitur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe të njëjtat do ti përcjell organit kompetent momentin e pranimit të ftesës apo në cdo kohë kur kërkohet nga ana e organit shqyrtues.

Duke pritur një përgjigje nga ana juaj!

Me respekt,

Parashtruesi i kërkesës

Tel.: 049-196-999